



Nr. 23 prot
Dt. 31/05/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 18, datë 20.05.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË
UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME PËR
UJË TA AMBALAZHUAR”, SHOQËRISË “GYSI” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Buna.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime sanitare, subjektit “Gysi” sh.p.k., me vendndodhje, Bashkia Shkodër, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

- X=456704
- Y=4657833
- Z=6.4 m.m.n.d

Vendndodhja e pikës, ku do të shfrytëzohet uji

- X=456731
- Y=4657815
- Z=6.4 m.m.n.d

Pika e shkarkimit

- X=456769
- Y=4657793
- Z=6.4 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

